

5.12 DËRGIMI I VËREJTJEVE

Vërejtjet dhe propozimet që kanë të bëjnë me funksionimin e programit COBISS3 mund t'i dërgoni në IZUM përmes postës elektronike.

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Njoftimet / Dërgimi i vërejtjeve**.
Hapet dritarja **Dërgimi i vërejtjeve**.
2. Tek fusha "Për" shfaqet adresa elektronike në të cilën do të dërgoni mesazhin. Adresën elektronike mund ta redaktoni ose mund të shënoni edhe ndonjë adresë tjetër.
3. Tek fusha "Nga" shfaqet adresa e shënuar tek atributi "Adresa elektronike" për emrin e përdoruesit, me të cilin keni hyrë në program. Vlerën mund ta ndryshoni.
4. Tek fusha "Subjekti" shfaqet titulli i mesazhit. Tekstin mund ta ndryshoni.
5. Tek fusha "Teksti" shënoni mesazhin që do ta dërgoni me postë elektronike.
6. Klikoni butonin **Në rregull**.